



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:183887

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05707210

C.nr.2804/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me praktikanten gjyqësore M.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.G.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e inflacionit në pagë, vlera e kontestit 415.94 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë **15.05.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET tërësisht e bazuar** kërkesëpadia e paditëses V.G.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të inflacionit në pagë.
- II. DETYROHET** e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të inflacionit në pagë, për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri më datë 31.05.2022 apo për vitin 2021 - 12 muaj (për çdo muaj shumën prej 5,05.00 euro, në shkallë prej 3.4% të pagës bazë -421.00 euro dhe për vitin 2022 - 5 muaj (për çdo muaj shumën prej 2,105.00 euro, në shkallë prej 11.6% të pagës bazë- 421.00 euro në emër të kompensimit për inflacion t'ia paguajë shumën prej 415.94 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 30.08.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja V.G.K. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i inflacionit në pagë, vlera e kontestit 920.89 euro, githëashtu ka theksuar se pala paditëse është e punësuar si mësimdhënëse në

institucionin arsimor “Dëshmorët e Kabashit” në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion dhe është e licencuar si mësimdhënëse.

I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datës 18.01.2024 ka kërkuar që paditëses ti njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datën 31.05.2022 dhe atë në shkallë të inflacionit për vitin 2021 në 3.4%, për vitin 2022 në 11.6 %, e në shumë të përgjithshme prej 415.94 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, për precizimin e padisë shumë prej 104 euro dhe për taksën gjyqësore shumë prej 20 euro, apo në shumë të përgjithshme prej 124.00 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 25.01.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësja ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është tërësisht e bazuar, andaj pas shqyrtimit të çështjes, e aprovoi tërësisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja V.G.K. është në marrëdhënie pune në institucionin arsimor “Dëshmorët e Kabashit” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të inflacionit në pagë, përkatësisht diferencës konkrete të paguar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata me numër të protokollit nr. 131 të datës 20.10.2015 vërtetoi faktin se paditësja është e punësuar në institucionin arsimor “Dëshmorët e Kabashit” në Prizren që nga viti 2015, dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie kontraktuale.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se

paditëses në emër të kualifikimit universitar, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjithashtu, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditëses kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizon paditësi dhe atë në shumën prej 415.94 euro, duke u bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe 2022, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditëses, e që është shuma prej 421.00 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 30.08.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritot, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Numri i lëndës: 2023:183887

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05707210

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.2804/23 të datës 15.05.2024

Gj y q t a r j a
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.